



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 738/1 prot.

Tiranë, më 27.02.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi *“Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit mbi bashkëpunimin policor”*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj me nr. 12647/3 prot., datë 18.02.2025, administruar me tonën nr. 708 prot., datë 18.02.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim, projekt marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit mbi bashkëpunimin policor (në vijim *“projekt marrëveshja”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i materialit të dërguar, vërejmë se parashikohet nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë, në kuadër të bashkëpunimit policor dhe sigurisë, në luftën kundër të gjitha formave të krimit, me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë për vendet palë të saj.

Ndërkohë, në pikën 2, të nenit 3 të projekt marrëveshjes, citohet se, ndërmjet shteteve palë do të shkëmbehet informacion për individë, grupe apo organizata terroriste, si dhe informacion mbi burimet e tyre financiare, të cilat konsiderohen të dhëna personale, sipas ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim *“Ligji”*).

Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit sugjeron të merren në konsideratë këto ndryshime dhe shtesa në tekstin e projekt marrëveshjes, në mënyrë që përmbajtja e saj të jetë konform Ligjit.

Pas pikës 4, të nenit 4 të projekt marrëveshjes, sugjerojmë të shtohet një pikë, me këtë përmbajtje:

“Kërkesa për ndihmë dhe shkëmbimi i informacioneve që përmbajnë të dhëna personale, do të realizohet duke përdorur mjete të sigurta komunikimi, në përputhje me legjislacionet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë”.

Në mbështetje të parashikimeve të nenit 66, të Ligjit, sugjerojmë që, në **pikën 1, të nenit 7, të projekt marrëveshjes**, togfjalëshi “...rregulloret e tyre” të zëvendësohet me fjalën “legjislacioneve”.

Gjithashtu, sugjerojmë që, në **nenin 7 të projekt marrëveshjes, të shtohet një pikë 3**, me përmbajtje, si vijon:

“3. Palët, në çdo rast, duhet të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, sipas parashikimeve të legjislacionit specifik për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë të kësaj marrëveshje”.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit, e vlerëson projekt marrëveshjen, të hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi